

Living

Sa të huaj, aq edhe shqiptarë

Editorial

2
T

Çifti që e quan
Tiranën
"shtëpi"!

“T” në Katror:

Çifti që e quan Tiranën “Shtëpi”

Sic e dimë të gjithë tani, Tirana dita-ditës po shndërrohet në një pikë të nxehtë jo vetëm në rajonin e Ballkanit, por edhe në Evropë, duke mbledhur qindra e mijëra turistë çdo ditë. Ajo që është interesante është se disa prej tyre, ne i konsiderojmë menjëherë “vizitorë” nëse dëgjojmë të flitet ndonjë lloj gjuhe e ndryshme nga e jona, por sapo bie në një bisedë me ta, zbulon se ata jetojnë dhe e shijojnë Tiranën në maksimum, ashtu si vendasit e vërtetë. Ky ishte edhe rasti im me Travis Ross dhe Tania Petrova. Në një të dalë me miqtë e mi në një nga baret e njohura të qytetit, një natë të ftohtë dimri, hyn brenda një vajzë e bukur me sy blu, me nuanca unike të ngjyrës gri, e shoqëruar nga një djalë i pashëm, me një kapele pellushi vendosur mbi kokë. Detaj ky, i cili më dukej sa për të qeshur dhe i lezetshëm në të njëjtën kohë. Me këtë pershtypje të parë të të dyve, që tanimë më ishte çimentuar në mendje, sigurisht që më duhej t’u afrohesha të dyve dhe të njihesha më shumë me çiftin tërheqës. U prezantova dhe biseda vazhdoi që andej, duke zbuluar se ata kishin ardhur nga SHBA-ja, nga ku Travis është me origjinë dhe Tania nga Ukraina. Çifti gjithashtu ndau se kanë një vogëlushe, shumë të adhurueshme, të quajtur Eva, e cila po qëndronte me nënën e Tanias atë natë. Nuk është faji im që e konsideroj “të thënë për t’u bërë” mundësinë që m’u krijua t’i takoja në atë moment. Pasi folëm për karrierën e Tanias si fotografe dhe pas një ngacmimi tepër hokatar me Travisin për kapelen e tij, i lashë ata vetëm për të shijuar natën e tyre, duke u premtuar se do të shiheshim përsëri.

Prej asaj dite, takimi fizikisht nuk ka ndodhur ende, megjithatë u sigurova që të mbaj kontakte, veçanërisht me Tanian dhe punën e saj, për t’ju sjellë juve pikërisht këtë intervistë që të ngroh zemrën. Një intervistë që më bëri të kuptoj se strategu ynë i aftë për biznesin e marketing-ut, Travis, është në fakt një i diplomuar në “Berkely College” në “Inxhinieri e Audios”, i apasionuar pas muzikës, me një botë të tërë krijimtarie që shtrihet nën atë pamjen e jashtme që gjeneron strategji biznesi, për të cilin familja është çdo gjë. Dhe Tania si një fotografe e arrirë, e publikuar në revistën “VOGUE”, plot me projekte të reja, të cilat i balancon me kujdes midis të qenurit një nënë prezente për vogëlushen e tyre Eva. Me të vërtetë, çifti është tepër interesant. Familja ka më pak se një vit e vendosur në Tiranë dhe mënyra se si përshkruajnë përvojën e tyre të deritanishme, më bëri të të dashurohem sërish me kryeqytetin tonë. Por jo vetëm kaq...



I inkurajoj thellësisht të gjithë lexuesit tanë që të vlerësojnë shumë mënyrën se si dy personazhet e rradhës flasin për njëritjetrin, jetën e tyre së bashku dhe planet e ardhshme. Dashuria e thellë, respekti, dëshira për fillime të reja dhe familja, janë ato për të cilat është biseduar bukur në këtë intervistë.

Mendoj se padyshim do të ishte interesante ta nisnim bisedën tonë me një pyetje të thjeshtë, por tepër të bukur: Si u takuat ju të dy?

Travis: U takuam në një aplikacion të quajtur “Badoo”. Është një aplikacion takimesh “online” në Ukrainë. I kërkoja Tania të dilnim në një takim dhe u takuam për të shkuar me skuterin tim deri në një park të qytetit. Hapëm një shishe verë dhe përfunduam duke bërë një xhiro në këmbë, në shinat e trenit, ndërsa dielli perëndonte dhe ne thjesht mund të themi se kimia e mrekullueshme ishte e pamohueshme. Që në takimin e parë e konsideruam njohjen tonë si një aventurë në krijim e sipër.

Tania: Ishte dita e parë e ngrohtë e pranverës, e bukur, moti ishte me diell. Pemët po lulëzonin dhe ishte vetëm fillimi i karantinës së gjatë të “Covid”-it. Mund ta

merrni me mend pas kësaj date, karantinimi gjatë Covid-it ndihej më pak i vetmuar.

Tania, ti si fotografe dhe Travis më shumë i apasionuar pas biznesit, si ia dilni me kreativitetin midis njëritjetrit?

Travis: Absolutisht! Mendoj se sinergia jonë buron nga mbështetja e ndërsjellë si në projektet tona krijuese, ashtu edhe në strategjitë e biznesit. Unë jam duke punuar me Al çdo ditë, duke udhëhequr gjenerimin e strategjive të biznesit për kompani të ndryshme të teknologjisë dhe softuerëve, por nuk kam qenë gjithmonë i gjithi “vetëm për biznesin”. E nisa jetën si muzikant. Si fëmijë mësova të luaja kitarë, isha në disa grupe dhe edukimi im muzikor frymëzoi krijimtarinë brenda meje. Unë jam tërhequr natyrshëm nga individë që nuk janë vetëm ambiciozë, por gjithashtu zotërojnë një shkëndijë të vërtetë krijuese dhe aftësi për ta kanalizuar atë në mënyrë efektive. Tania është një “central elektrik”, i mbushur me energji kreative dhe mjeshtëria e saj në estetikë, fotografi dhe dizajn më frymëzon vërtet. Mbështetja ndaj saj nuk ka të bëjë vetëm me partneritetin; ka të bëjë me dëshirën time që ajo të arrijë potencialin e saj të plotë, që besoj se është një testament i aspiratave

tona së bashku. Për mua, ka të bëjë me zhvillimin e kontributit tonë në botë, shfrytëzimin e krijimtarisë sonë për të patur një ndikim domethënës. Tania është partnerja perfekte në këtë udhëtim, duke ndihmuar për të sjellë më shumë dritë në botë me çdo projekt që trajtojmë së bashku, ashtu si dhe vetëm ajo vetë.

Tania: Travis shkëlqen në marketing. Ne gjetëm një mënyrë për t’i bashkuar idetë tona, duke rritur rrugët tona individuale drejt suksesit. Merrni për shembull kohën tonë në Amerikë; Sapo po filloja biznesin tim të fotografisë dhe njohuritë e Travis ishin të paçmueshme. Ai e kuptoi shpejt atë që kërkonin klientët dhe më ndihmoi të synoja audiencën e duhur me saktësi strategjike. Për më tepër, ai ishte i dobishëm në krijimin dhe organizimin e operacioneve të biznesit tim që nga nisja. Mbështetja e tij e palëkundur ka qenë gjithmonë një shtyllë për mua; ai është dikush që jo vetëm më dëgjon dhe më mbështet, por edhe më drejton në kohë sfiduese, diçka që unë e vlerësoj thellësisht. Travis beson vërtet në talentin dhe suksesin tim, dhe kam respekt të jashtëzakonshëm për mprehtësinë e tij, intelektin që posedon dhe aftësinë intuitive.

Travis: U takuam në një aplikacion të quajtur “Badoo”



Tania: Eva është prioriteti dhe projekti im kryesor tani.



Ne gjithashtu e dimë përmes llogarive tuaja sociale, se ju jeni prindër të një vajze të vogël e të bukur, e quajtur Eva. Si e ndryshoi prania e saj jetën tuaj, perspektivën tuaj të së ardhmes?

Tania: Eva është prioriteti dhe projekti im kryesor tani. Kam punuar shumë për të arritur sukses në Amerikë, duke vazhduar gjithashtu të punoj si fotografe këtu, dhe megjithëse gjithçka nuk është ngritur lehtë, kur Eva lindi, u duk e natyrshme të tërhiqesha nga karriera ime fillimisht. Prania e Evës më bëri të kuptoj edhe më shumë se dua të jem një shembull i mirë për të, veçanërisht në këtë botë sfiduese. Unë dua që ajo të dijë përgjigjet e pyetjeve të famshme si “Kush e drejton botën?” [Ju e dini atë këngën e Beyonce-s] dhe të ndihet e fuqizuar që ajo mund të jetë dikush në të ardhmen që ndikon në këtë botë. Kjo është arsyeja pse unë vazhdoj ende të ndjek pasionin për fotografimin, sepse dua të jem e suksesshme në karrierën time dhe të jem një shembull për të.

Travis: Mendoj se prania e Evës padyshim që më bëri të vlerësoja një gjumë të mirë natën shumë më tepër se kurrë më parë. Mendoj se më bëri pak më të vjetër, në kuptimin që duhet të mendosh për të ardhmen dhe ndalon të mendosh më shumë për vendimet që merr. Ti dëshiron t'i bësh gjërat siç duhet, ndërsa kjo nuk është një gjë aq e rëndësishme kur je më

i ri. Kur ke një fëmijë, edhe me mungesën e gjumit, ndjen shumë gëzim dhe energji shtesë që mund të përqendrohen drejt qëllimeve që ke dhe gjërave që dëshiron të arrish, sepse shikon shkëlqimin në sytë e fëmijës tënd dhe kjo thjesht të bën të buzëqeshësh brenda pothuajse gjatë gjithë kohës. Pra, është me të vërtetë një përzierje midis punës shtesë dhe plotësimit në jetë që mungonte kur isha më i ri dhe thjesht bëja festë, dhe isha kreativ gjatë gjithë kohës.

Duke folur për fëmijët, besoj se të gjithë lexuesit tanë do të donin të dinin se si ju erdhi ndërmend “Shqipëria” si një vend ku të ristaciononi familjen? Si e gjetët veten këtu?

Travis: Epo, më duhet të them që hodhëm një shigjetë në hartë dhe Shqipëria fitoi lotarinë. Mendoj se pamë disa vende të ndryshme dhe kryesisht mendonim të largoheshim nga Ohio, sepse, sinqerisht, ishim mërzitur atje. Për të qenë i sinqertë, duke qenë se jam rritur në Gjermani, isha mësuar më shumë me stilin e jetës evropiane dhe pikërisht këtu ndihem më rehat. Natyrisht, Tanya është nga Ukraina, ne jemi takuar në Lviv, i cili ka një mjedis shumë evropian. Thjesht nuk mund të përballonim stilin e jetës periferike. Ne donim të ktheheshim në Evropë, por diku që do të përshtatej me buxhetin tonë dhe gjithashtu do të ishte një vend shumë

interesant për t'u eksploruar. Më e rëndësishmja, duhej të ishte ngrohtë dhe ushqimi nevojitej të ishte shumë i shijshëm. Tanya dhe unë nuk kishim qenë kurrë në Shqipëri më para se të transferoheshim këtu. Nuk kishim miq këtu, nuk kishim familje, as ndonjë mik që kishte qenë këtu më parë. Pra, është një pjesë e stilit tonë të jetesës si një aventurë, njëjtë si koha kur u transferuam për të jetuar në Jukatan, Meksikë, për disa muaj, dhe më pas në Stamboll para kësaj.

Kur bëhet fjalë për industrinë krijuese Tania, a e sheh Tiranën të frytshme, një qytet i orientuar drejt mundësive, përsa i përket punës dhe talentit tënd?

Unë absolutisht e shoh këtë qytet si një vend ku mund të shfaq plotësisht potencialin tim. Vë re se këtu ka një kërkesë të madhe për punën time. E kam mjaft të lehtë të gjej klientë, megjithëse nuk i kërkoj në mënyrë aktive - në vend të kësaj, janë ata që kërkojnë rregullisht shërbimet e mia. Kam vënë re se njerëzit vendas e vlerësojnë estetikën dhe punën time, kjo më gëzon shumë.

Ju jetoni prej pak kohësh këtu, në Tiranë. Jam kurioz për përvojën tuaj me qytetin, veçanërisht përshtypjet tuaja të para, kur mbërritët për herë të parë dhe si ju pritën njerëzit, vendasit?

Travis: Përshtypja jonë e parë

për Tiranën ishte jashtëzakonisht pozitive. Qyteti gumëzhin me një energji emocionuese, aktiv dhe me lëvizje kudo. Edhe pse ndonjëherë mund të jetë e lodhshme është relaksuese të arratisesh në parkun e madh ose të bësh udhëtime të shkurtra në qytete dhe vende të afërta, falë vendndodhjes së përshtatshme të Tiranës. Njerëzit këtu kanë qenë tepër mikpritës, pavarësisht zhurmës masive të qytetit nga makinat në rrugë. Në përgjithësi, është një mjedis i gjallë dhe pozitiv.

Tania: Kur mbërritëm në dhjetor 2023, menjëherë na kënaqi moti me diell, i ngrohtë, një ndryshim i këndshëm nga andej ku erdhëm. Unë u emocionova kur zbulova se nuk kishim nevojë për një makinë këtu; ne mund të ecim kudo. Bollëku i frutave dhe perimeve të freskëta të shitura gjithandej ishte mahnitëse, dhe ato janë thjesht shumë të bukura. Të të bërit pazar vetëm poshtë shtëpisë ishte një lehtësi që ne e vlerësuam shumë. Ajo që më befasoi më shumë ishte se sa shumë njerëzit i adhurojnë foshnjat këtu. Kudo që shkonim me Evën, njerëzit i buzëqeshnin gjithmonë dhe ishin tepër bujarë, duke na dhënë shpesh ëmbëlsira apo dhurata të vogla vetëm sepse ishim me të. Me të vërtetë momenti ynë i parë u ndje si një pritje e ngrohtë.

A ndiheni sikur tani jeni përshtatur plotësisht këtu? Është një qytet i vogël në fakt.

Travis: Ngadalë, por me siguri që po. Po, më duket sikur e shohim

ende Tiranën si një hapësirë “masive”, kryesisht sepse nuk e flasim gjuhën dhe nuk kemi pasur shumë kohë për t’u integruar thellë në atmosferën e komunitetit që qyteti ka. Ka qenë një proces i ngadaltë, por ne jemi shumë të hapur për të bërë miq dhe për të shfrytëzuar çdo shans për të mësuar më shumë për jetën e njerëzve këtu. Për shembull, në një festival, takuam një çift vendas, nuk ua mbaj mend emrat, por ata ishin një çift shumë i bukur, gjithashtu me një fëmijë të vogël. Ishte fantastike të lidhesha me prindër të tjerë që janë aventurierë, shijojnë daljet dhe argëtimin, njësoj si ne. Pra, mendoj se ka shumë njerëz të tjerë këtu që duhet të takojmë, të cilët do të përputhen mirë me stilin tonë të jetesës globale, krijuese, fëmijët dhe gjithçka!

Cilat janë 3 gjërat që keni pëlqyer gjatë kohës që keni kaluar deri tani në Shqipëri dhe 3 gjërat që keni kuptuar se keni një mos pëlqim?

Travis dhe Tania: Ka shumë për të çmuar dhe disa gjëra për t’u përshtatur këtu në Shqipëri. Duke filluar me pozitivet, ne absolutisht e duam motin. Ushqimi këtu është fantastik. Ne kemi kultivuar vërtet një shije për kuzhinën vendase. Ecja nëpër qytet është një tjetër e preferuar e jona, veçanërisht vizitat në parqe, ato ofrojnë një pushim të nevojshëm nga ngutja urbane. Nga ana tjetër, ka disa aspekte që i kemi parë sfiduese. Ecja me makinë këtu mund të jetë mjaft e pamatur dhe e frikshme, gjë që është veçanërisht prezente kur kalojmë rrugët me

fëmijën tonë. Një çështje tjetër është tymi i cigares, i cili duket i përhapur kudo dhe i vështirë për t’i shpëtuar. Së fundi, është dëshpëruese të shohësh njerëz që hedhin mbeturina, veçanërisht kur plehrat hidhen në rrugë e jo në vendin përkatës.

Lidhur me të ardhmen tuaj dhe planet që mund të keni bërë për të: A është në fokus të kaloni më shumë kohë në Tiranë? A mund ta quajmë atë një vend gjysmë të përhershëm për familjen tuaj të bukur?

Travis: Ne patjetër po shqyrtojmë nëse duam të angazhohemi për një qëndrim afatgjatë këtu, duke folur nga ana ligjore. Ndoshta do të marrim një vendim përfundimtar në muajt e ardhshëm. Varet si do të vijjnë gjërat kur të vijë koha për të zgjedhur, por më duhet të them se pas një udhëtimi në Itali, Greqi dhe Gjermani së fundmi, kthimi në Tiranë ndihet gjithmonë qetësues. Është gjithmonë mirë të kthehesh këtu, kështu që do të shohim!

Tania: Tirana është bërë shumë komode për ne. Siç përmendi Travis, sa herë që kthehemi nga udhëtimi, na duket sikur kthehemi në shtëpi. Ne e duam shumë apartamentin tonë, pamjen e maleve, dhe ka shumë gjëra për Shqipërinë dhe Tiranën që na pëlqejnë. Sigurisht që do të jetë një pjesë e rëndësishme e planeve tona të ardhshme.

Dhe pyetja jonë e fundit në këtë bisedë tepër të këndshme me ju, më shumë për Taninë, këtë Travis: Duke qenë një fotografe



e publikuar në “VOGUE”, cilat janë projektet e tua të mëdha të ardhshme, nëse mund të ndash diçka me ne këtu në “LIVING”?

Kam pasur fatin që punimet e mia të botohen në disa revista dhe kam qenë e përfshirë në një sërë projektesh interesante. Tani, jam shumë e emocionuar për një projekt timin, projektin e ëndrrave: Një ekspozitë personale. Vizualizoj një ekspozitë në galeri, ku fotot e mia shfaqen në formate të mëdha, të ndriçuara në mënyrë profesionale dhe të kornizuar bukur. Ndihet si hapi i ardhshëm, më duket i natyrshëm, në karrierën time. Gjithashtu mezi pres të ndërmarr disa projekte unike dhe inovative pikërisht këtu në Tiranë. Do të ishte fantastike nëse do të kisha mundësi për t'u angazhuar me komunitetin krijues vendas, të cilin unë e respektoj shumë dhe dua të bëhem pjesë e tij.

Dhe me këtë e mbylлим bukur. Shumë suksese Tania! Faleminderit shumë që më lejuat të realizoj këtë intervistë, me të vërtetë ishte një kënaqësi.

Faleminderit Nini dhe faleminderit “LIVING” për mundësinë, kënaqësia dhe nderi ishte i gjithi i yni.

VOGUE

